



Prishtinë, 22.04.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3150_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Ankesën e konsumatorit në ZRrE të dt. 14.05.2025;
- Rekomandimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK_R_2957_04_26, i dt. 07.04.2026.

në seancën e mbajtur më datë 22.04.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e aplikuesit **A.H., – Peak Valley LLC.**, nga Komuna e Prishtinës, si e bazuar.
- II. OBLIGOHET Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** që t'i ofroj aplikuesit Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike, për t'u kyçur në daljen 10(20)kV Sharbanët, sipas kërkesës së tij.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 07.04.2026 ka nxjerrë Rekomandim për Bordin e ZRrE-së me nr. ZRrE_R_2957_04_26, me të cilin i rekomandon Bordit që të aprovohet si e bazuar ankesa e aplikuesit A.H., – Peak Valley LLC., ashtu që, të obligohet Operatori i Sistemit të Shpërndarjes që t'i ofroj aplikuesit Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike, për t'u kyçur në daljen 10(20)kV Sharbanët, për projektin e tij Peak Valley, për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet prej 1 MWp.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe Rekomandimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se ky Rekomandim si i tillë është i drejtë dhe i bazuar në prova materiale si në shkresat e lëndës.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit në ZRrE e dt. 14.05.2025, Rekomandimin e DMK-së të dt. 07.04.2026, Pëlqimin Elektroenergjetik me nr. 3100, i dt. 14.03.2025 të KEDS, Përgjigjen e KEDS me nr. 5579 e dt. 08.05.2025, të dhënat e KEDS për ngarkesën e daljes 10(20)kV Sharbanët, me kod: 14016003 si dhe për NS 35/10kV Koliqi, sqarimet e tjera të ofruara nga KEDS, analizat dhe simulimet e tjera, Përshkrimin Teknik të Projektit si dhe provat e tjera materiale si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të



shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e aplikuesit **është e bazuar**, sepse:

Me datë 14.03.2025, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS – Njësia e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme, i ka lëshuar konsumatorit Pëlqimin Elektroenergjetik me nr. 3100, për aplikuesin A. H., projekti i quajtur “Peak Valley”, me veprimtari – prodhimin e energjisë elektrike nga energjia solare, me fuqi të transformatorit $S_{inst} = 1000$ kVA, dhe me fuqi maksimale të njëkohshme të gjenerimit prej $P_{mnj} = 1$ MW. Më tej, në këtë PEE, Kushtet Teknike përcaktohen si në vijim:

1. Nënstacioni i KEDS prej nga do të furnizohet objekti: “NS 35/10kV Koliqi”
2. Niveli i tensionit në pikën e kyçjes: 10(20) kV
3. Vendi i pikës kyçëse: NS 35/10 kV Koliqi
4. Vendi i pikave matëse: Kthina matëse në NS 35/10 kV Koliqi
5. Mënyra e kyçjes, sipas Zgjidhjes Teknike të bashkëngjitur në këtë PEE.

Pas pranimit të PEE dhe ZT, aplikuesi A. H., ka parashtruar Kërkesë për Revidim të PEE dhe ZT me nr. 3100, të dt. 14.03.2025, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së aplikuesit, nga KEDS – Njësia e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme, i është përgjigjur aplikuesit, përmes Përgjigjes me nr. 5579 e dt. 08.05.2025, si në vijim: *“Kërkesa juaj për revidim të PEE-së refuzohet dhe në fuqi mbesin kushtet e dhëna sipas PEE dhe ZT, me nr. 3100 e dt. 14.03.2025, me arsyetimin se – për shkak të konsumit të ulët në daljen 10(20) kV Sharbanët, kyçja e gjeneratorit me kapacitet 1MWp do të kishte ndikim negativ në rrjetin e shpërndarjes. Për më tepër, duke qenë se, fuqia gjeneruese e kërkuar është më e madhe, se kërkesa për konsum në atë dalje 10(20)kV, do të ndodhte një rritje e tensionit në zarrat e trafostacioneve të kyçur në afërsi të gjeneratorit të planifikuar. Bazuar në simulimet e realizuara përmes softuerit Digsilent Power Factory”, në rastet kur konsumi do të ishte minimal dhe gjenerimi maksimal, do të ndodhnin devijime të tensionit, e që potencialisht, do të shkaktojnë probleme për konsumatorët fundor. Për konsumatorët fundor ekzistues pranë pikës së propozuar të kyçjes, niveli i tensionit aktual, pa gjenerim është 10.14 kV. Megjithatë,, me kyçjen e gjeneratorit të kërkuar, niveli i tensionit mund të arrijë deri në 10.91 kV. Ky ndryshim i tensionit për konsumatorët fundor, do të shkaktonte luhatje të tensionit, që mund të dëmtojë pajisjet elektrike, duke shkaktuar rrezik për funksionimin e sigurt në rrjetin e shpërndarjes”.*

I pakënaqur me këtë Përgjigje, dhe brenda afatit ligjor, aplikuesi me dt. 14.05.2025, ka parashtruar ankesë në ZRrE/DMK, duke theksuar ndër të tjera se – lidhur me pikën e kyçjes më rrjetin elektroenergjetik për projektin e parkut solar në fsh. Tërrenvë – Podujevë, që na është caktuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) në Pëlqimin Elektroenergjetik. Pika e caktuar nga OSSH për kyçje në NS 35/10(20)kV Koliqi, ndodhet 8 km larg nga vendndodhja e projektit tonë. Në këtë kuptim, është jopraktike dhe nuk përputhet me fizibilitetin teknik dhe ekonomik të projektit tonë. Kërkesa jonë ka qenë që të kyçemi në fund të linjës 10(20) kV Sharbanët, që ndodhet në një linjë ekzistuese 10 kV - 120 m larg parkut diellor. Kjo vendndodhje, është dukshëm më afër vendit të projektit tonë, dhe shumë më e përshtatshme për arsyet e mëposhtme: arsyetimi teknik i KEDS për kufizimin e kapacitetit nuk është i saktë, edhe sa i përket fizibilitetit teknik, reduktimit të humbjeve, stabilitetit të tensionit, fizibilitetit ekonomik, përfitimet për rrjetin, e të ngjashme. Kërkon nga ZRrE rishqyrtimin e kësaj çështje dhe ta udhëzojë KEDS që të ri caktojë pikën e lidhjes më rrjetin, sipas kërkesës së konsumatorit.



Aplikuesi ka aplikuar për Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike, në Kompaninë Kosovare për Distribuim me Energji, dhe kjo duke iu referuar nenit 9 – Aplikimi për Kyçje dhe Oferta e Kyçjes, të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes, si vijon: *“Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike. 2. Proces i kyçjes për njësitë gjeneruese ose konsumatorëve prodhues është i njëjtë me procesin e kyçjes për konsumatorët fundor”. Më tej, në par. 6 të këtij neni përcaktohet se: “Në rastet e aplikimeve për kyçje të njërive gjeneruese në rrjetin e shpërndarjes, njësitë gjeneruese të BRE-ve kanë përparësi ndaj atyre konvencionale”.*

Pas shqyrtimit të kërkesës, konsumatorit i është lëshuar Pëlqimi Elektroenergjetik me nr. 3100 dhe atë me dt. 14.03.2025, ku ndër të tjera, pika e kyçjes konsumatorit i është caktuar në NS 35/10kV Koliqi, çka edhe paraqet çështjen kryesore kontestuese lidhur me këtë rast.

Sipas dokumentacionit relevant, rezulton që, kërkesa e aplikuesit, e parashtruar tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përmes së cilës ka kërkuar Pëlqim Elektroenergjetik për Kyçjen e Gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaiik me fuqi të instaluar Pm_{nj} – 1 MWp, për t'u kyçur në daljen 10 kV – Sharbanët, pranë TS 14016003. Fillimisht nga KEDS, konsumatorit i është lëshuar një Informatë, përmes së cilës i njoftohet si në vijim: *“Kërkesa juaj refuzohet, për shkak të profilit të ulët të ngarkesës së daljes 10(20)kV Sharbanët me kod 14016003, e cila dalje furnizohet nga NS 35/10kV Koliqi, e që është në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj. Prandaj KEDS nuk mund të jap kyçje për kapacitete të reja gjeneruese, marrë parasysh kapacitetin pritës për BRE në këtë zonë”.* Ndërkaq, pas lëshimit të PEE-së, pika e kyçjes, konsumatorit i është dhënë tek NS 35/10 kV Koliqi.

Rrjedhimisht, konsumatori pretendon që – pika e kyçjes tek NS 35/10 KV Koliqi, është në distancë prej **8 km larg**, nga vendndodhja e projektit, në krahasim me pikën e kyçjes të kërkuar nga aplikuesi tek NS 10(20) kV Sharbanët, që ndodhet rreth **120 m distancë** nga vendi i planifikuar për ndërtimin e parkut diellor.

Në këtë kuptim, Bordi i ka analizuar me kujdes të dhënat për ngarkesën e NS dhe sqarimet e ofruara nga KEDS në lidhje me ngarkesat në daljen 10(20)kV “Sharbanët” me kod: 14016003 si dhe nënstationin e KEDS NS 35/10kV Koliqi, duke theksuar se aplikuesi i plotëson kushtet për kapacitet më të vogël përkatësisht për kapacitetin 540 kW dhe jo për 1 MWp për vendin e kërkesës për kyçje duke sqaruar se:

- Kapaciteti i instaluar i NS Koliqi, është 5MVA;
- Kapaciteti termik i “Dalja 10kV Sharbanët”, i cili është 2.511 MVA;
- Ngarkesa mesatare e daljes në periudhën e verës(Qershor –Gusht) për periudhën kohore 07:00-19:00 është 0.54 MW (viti 2023).

Kyçja e gjeneratorit me këtë kapacitet, pra totali i kapacitetit gjenerues në këtë dalje nuk do të tejkaloj 60%, (1.5065 MVA) të kapacitetit termik të lejuar të cilin KEDS e ka parapërcaktuar si vlerë për ngarkesë të linjës nga Gjeneratorët si dhe totali i kapacitetit gjenerues në këtë dalje nuk do të tejkaloj 30% të fuqisë së instaluar të nënstationit, e që është 1.5MVA.



Bordi ka analizuar kriteret për përcaktimin e kushteve teknike të gjeneratorëve të BRE-së për realizimin e kyçjes në rrjetin e OSSH-së e të cilat përdoren nga OSSH në rastet e kërkesave për lëshimin e PEE nga aplikuesit dhe konstaton se këto kriteret nuk janë të përcaktuara në Legjislacionin primar dhe sekondar, Kodet teknike si dhe të njëjtat nuk janë të aprovuara nga ZRRE.

Po ashtu, Bordi e ka analizuar informatën si dhe sqarimet shtesë për kërkesën e aplikuesit dhe konstaton se mesatarja e ngarkesave për daljen Sharbanët 10(20)kV me kod: 14016003 për periudhën 01/2023 deri në periudhën 12/2023 është **620 kW**, periudhën 01/2024 deri në periudhën 12/2024 është **616 kW** si dhe për periudhën 01/2025 deri në periudhën 12/2025 është **664kW**, kurse për periudhat verore 06/2023 deri në periudhën 08/2023 është **517 KW**, për periudhën 06/2024 deri në periudhën 08/2024 është **526 KW** si dhe periudhën 06/2025 deri në periudhën 08/2025 është **544 KW**. DMK po ashtu ka gjetur P_{MAX} për çdo muaj, ku mesatarja e P_{MAX} për vitin 2023 është **1.12 MW**, për vitin 2024 është **1.13 MW** dhe për vitin 2025 është **1.24 MW** si dhe për periudhat verore 06-08/2023 është 0.96 MW, periudhën 06-08/2024 është **1.06 MW** si dhe periudhën 06-08/2025 është **1.01 MW**. Aplikuesi po ashtu ka dorëzuar në ZRRE Raportin për dizajnin e mundshëm të Gjeneratorit në të cilin janë të përshkruara specifikat e projektit. Sipas të dhënave të ofruara, vërtetohet se injektimi maksimal i energjisë në rrjet mund të jetë **875 kW** kurse kapaciteti instalues i gjeneratorit do të jetë **1085.8 kW**, ku shkalla e konvertimit DC/AC është 1.24. Po ashtu vërtetohet se numri i paneleve të instaluar do të jenë 1,508 secila me kapacitet gjenerues 720 Wp e që vlera e tyre përputhet me kapacitetin instalues **1085.8 kW**.

Duke u bazuar në të gjitha analizat e bëra e në veçanti ngarkesat në daljen Sharbanët 10(20)kV me kod: 14016003 si dhe simulimet e bëra, Bordi konstaton se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, ka mundësi që ta akomodojë kërkesën e aplikuesit për projektin Peak Valley, ashtu që, i njëjti, të kyçet në daljen Sharbanët 10(20)kV me kod 14016003, në pikën më të afërt të përshtatshme për aplikuesin, duke i marrë në të njëjtën kohë, të gjitha masat e parapara me Kodin e Matjes si dhe Kodin e Rrjetit të OSSH-së, për përcaktimin e kushteve (normave) teknike të parapara për kyçjen e aplikuesit (Gjeneratorit) për operim stabil dhe të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes, bazuar në kërkesën e Aplikuesit duke marrë për bazë edhe luhatjet e mundshme të Tensionit për konsumatorët fundorë. Bazuar në analizat teknike për rastin e kyçjes së gjeneratorit përkatësisht simulimeve të bëra, vërtetohet se kemi furnizim brenda standardeve të parapara me Kodin e Rrjetit të OSSH. Në nenin 3.6.2.3 thuhet se: “OSSH do ta operojë Sistemin e Shpërndarjes ashtu që të sigurojë që tensioni nëpër termialet e sistemit të furnizimit, siç është definuar në standardin IEC 50160 (pika 4.3.1 dhe 4.3.2), të përputhet me këtë standard. Toleranca e brezit të tensionit të nivelit të TM dhe TU±10%, në raste të veçanta +10, -15. Tensioni rezultues në pika të ndryshme në sistem varet nga disa faktorë, por në pikën lidhëse më të largët-teknikisht me konsumatorët mund të pritët të jetë në përputhje me të dhënat e më poshtme: Tensioni nominal për nivelin 10 kV është 10 kV ku toleranca e brezit luhatjes është: Tensioni maksimal (+10%) 11 kV, Tensioni minimal (-10%) 9 kV kurse për Tensionin Minimal (-15%) 8.5 kV”. Në bazë të kalkulimeve vërehet se në asnjë rast nuk kemi tejkalim, pra ndikim në rritjen e mbi tensioneve, por përkundrazi, kemi përmirësim të tensionit nga tensioni nominal me kyçjen e Gjeneratorit.



Bordi i ZRRE-së pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti kërkesat e aplikuesit në KEDS, Përgjigjen e KEDS, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes, Ligjit për Energjinë Elektrike, si dhe kodet teknike ne fuqi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KEDS;
- Aplikuesit **A.H.**,
- Arkivit të ZRRE-së.